


## Udhëzim mbi montimin Pllakat Cleaneo® Akustik FF

### E re


- E gatshme për tu montuar me brinjë të shkallëzuar dhe të paratrajtuar me primer

## Cleaneo® Akustik FF




Brinjët e pllakës Cleaneo® Akustik FF janë të parafabrikuara të shkallëzuara dhe të paratruara.

## 2 Kontrollohen paraqitja e vrimave




Paraqitja e vrimave gjatë procesit të montimit kontrollonhet vazhdimisht, nëpërmjet linjave të drejta dhe diagonale, rreshtat e vrimave tek bashkimet e pllakave e përtej (shiko skicën faqe 4)

## 5 Mbushen fugat (me Knauf Uniflott)




Maja plastike prehet në gjerësinë e fugës dhe futet në tubet. Me ndihmën e pistoletës së dorës, fugat mbushen bollshëm me stuko Knauf Uniflott. Kokat e vidave stukohen gjithashtu. Si alternativë, stukimi për sipërfaqe të mëdha mund të realizohet edhe me Jet-Pistolet dhe presion ajri.



Forma speciale e brinjëve të pllakës Cleaneo® Akustik FF me nga një brinjë ballore dhe gjatësore FF si dhe me nga një brinjë ballore dhe gjatësore SK, bëjnë të mundur një renditje të thjeshtë dhe precize të vrimave në bashkimet e pllakave.


Për montim këshillohet një ekip prej 3 montuesish.

## 3 Fiksimi i pllakave



Pllakat Cleaneo® Akustik FF fiksohen me vida të shpejta SN 3,5 x 30 në konstruksionin metalik prej profileve CD 60x27. Distanca ndërmjet vidave 170 mm. Gjatë fiksimit, pllaka shtyhet fort në profilin mbajtës. Vidhimi fillon nga këndet, ku pllaka në anën gjatësore dhe ballore kufizohet me pllakën tashmë të fiksuar. Fillimisht vidhohet brinja gjatësore, më pas brinja ballore.


## 6 Largohet materiali i tepërt i stukos



Pasi materiali i stukos Knauf Uniflott të jetë fortësuar, largohet materiali i tepërt.

Alternativë: Fugat e mbushura para tharjes së Knauf Uniflott me stuko-Jet shtrihen pastër dhe materiali shtesë i stukos zmerilohet pas tharjes së plotë të tij.


## 1 Rregullimi i pllakave



Gjatë montimit gjithmonë brinjët ballore dhe gjatësore FF bashkohen me brinjët SK. Spango niveluese vendoset dhe fiksohet në mesin e dhomës në drejtimin e shtrimit.


1. Rradha e pllakave rregullohet dhe fiksohen në drejtimin e spangos. Rradhët e tjera të pllakave montohen sipas skemës së shtrimit (shiko fq.3).

## 4 Fugat pastrohen



Pas mbarimit të montimit të tavanit, pastrohen fugat në rast se ka mbeturina pluhuri, me penel ose furçë.


## 7 Stukimi final



Stukimi vijon me Knauf Finisch Pastös ose Readygips, vendosur hollë mbi fugë (dy duar). Në rast se vrimat mbushen me stuko, hapen duke përdorur diskun e vrimave të përshatshëm për formatin e vrimës. Në përfundim sipërfaqja e thatë e stukuar lëmohet për tu sheshuar.

## Skema e montimit për sipërfaqe të mëdha tavani

Schemazeichnung



### Veglat e punës për montimin e pllakave Cleaneo® Akustik FF

#### Pistoletë dore


Pistoletë	Nr.Art. 00004657
Majë rezervë	Nr.Art. 00047065
Tubet me majë	Nr.Art. 00004707

#### Pistoletë me presion ajri

Pistolet Jet	Nr.Art. 00073963
Uniflott-Set adaptues për pistoletën Jet	Nr.Art. 00096407

#### Veglat për lëmim (zmerilim)

Lëmues dore	Art.Nr. 00004700
Rrjetë për lëmim 100	Art.Nr. 00004703
Lëmues dore me letër zumpara	Art.Nr. 00100586
Rreta lëmuese rezervë 120	Art.Nr. 00103031



**Udhëzime**

- Paraqitja e përgjithshme e tavanit duhet kontrolluohet gjithmonë nëpërmjet linjave të drejta dhe diagonale të rreshtave të vrimave
- Pllakat Cleaneo® Akustik FF vendosen kryq

Knauf Direkt  
Shërbimi telefonik:  
▶ Tel.: ++35542248714  
▶ Fax: ++35542257761

▶ [www.knauf.al](http://www.knauf.al)

Fabrika: Knauf Radika AD bul. 8 Shtetëzori bb. MK-1250 Debar

\* Knauf Tirana shpk Rr. Jeronim De Rada, Kulla 2, Kati 2, Tirana-AL



Ruhet e drejta e ndryshimeve teknike. Vlen botimi përkatës aktual.  
Të dhënat mbi konsumin, sasinë dhe mënyrën e punës janë të testuara si dhe të zbatuara në praktikë.  
Për të gjitha ndryshimet, ribotimet, kopjimet e plota dhe të pjesëshme, kërkohet miratimi i plotë i firmës Knauf.